

E.S Financial Advisory shpk
Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR
Licensa Nr.260, Date 27.08.2012
Adresa: Rruga Tefta Tashko Koço, Pall 132, Ap 1, Tirane
Mob. 0696002295
e-mail: erjons@gmail.com /officecloud.adv@gmail.com

Partia Konservatore

Tiranë, më 23.02.2024

Lënda: Informacion në lidhje me mosrealizimin e shërbimit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, si dhe për zgjedhjet e pjesshme vendore në bashkinë Kukës të datës 24 Shtator 2023, Partia Konservatore.

Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) nr.221, datë 23.01.2024, jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (auditues ligjor) për auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, si dhe për zgjedhjet e pjesshme vendore në bashkinë Kukës të datës 24 Shtator 2023 për 4 (katër) Parti Politike, midis të cilave ishte dhe **Partia Konservatore**.

Menjëherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, ne kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me Partinë, **Partia Konservatore** për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit me poste të letres me kthim përgjigje, në adresën e selisë së partisë.

Ne derguam shkresën për fillimin e procedurave të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara të fushatës të datës 14 Maj 2023 për këtë subjekt zgjedhor (bashkangjitur), dhe posta na e ktheu për mosgjetje adrese.

Gjithashtu Ne kërkuam dhe në menyra të tjera për të mundësuar kontakt me drejtuesin e subjektit zgjedhor por nuk arritem të kontaktonim me asnjë nga menyrat. Ne kërkuam dhe KZQ-se më datë 30.01.2024 është dërguar në adresën zyrtare të partisë: enxhi.podgorica@kqz.gov.al në të cilën është kërkuar takim me Z.Bashkim Murati për të na vënë në dispozicion informacionin për fillimin e procesit të auditimit.

Për këtë Parti u përdor çdo komunikim që na u vunë në dispozicion nga KQZ si adresë selie, informacione nga ekspertët paraardhës në misione të ngjashme, si edhe kërkime në internet, por të gjitha mënyrat e përdorura nuk sollën rezultat.

Ne kërkuam edhe në faqen zyrtare të KQZ-së për raportimin financiar të fondeve të fushatës të datës 14 Maj 2023 të subjekteve zgjedhore por nuk gjetëm ndonjë raport në lidhje me Partinë Konservatore.


Gjithashtu edhe nga raportet e monitorimit nuk rezultoi ndonjë gjetje.

Bashkangjitur dokumentacioni vërtetues:

- Letra e dërguar me postë dhe zarfë kthyer mbrapsht nga shërbimit postar për mos gjetje adrese.
- Kërkimi në faqen e KZQ për Raportim Financiar

Adresa e dërguar në adresën e partisë : Njesia bashkia Nr 8,Rruga e Dibres ,nr 66 ,hyrja 12 kodi postar 1017-F44.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!
E.S Financial Advisory shpk
Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR



E.S Financial Advisory shpk
Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR
Licensa Nr.260, Date 27.08.2012
Adresa: Rruga Tefta Tashko Koço, Pall 132, Ap 1, Tirane
Mob. 0696002295
e-mail: erjons@gmail.com / officecloud.adv@gmail.com

Tiranë, më 26.01.2024

Lënda: Kërkesë për fillimin e procedurave të auditimit ligjor

Për: Partia Konservatore
Drejtuar kryetarit: Z. Bashkim Murati
Adresa e selisë: Njesia bashkia Nr 8,Rruga e Dibres ,nr 66 ,hyrja 12 kod postar 1017-F44.

Sipas kontratës nr.221 prot. datë 23.01.2024 ,me palën angazhuese KQZ-në, objekti i misionit të auditimit është: *"Kryerja e auditimit të detyrueshëm te partive politike të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te dates 14 maj 2023 ,si dhe per zgjedhjet e pjeshme vendore ne bashkine Kukes te dates 24 shtator 2023 në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre"* dhe afati kufi i përfundimit të procesit te auditimit eshte data 23.02.2024


Për kryerjen me sukses të misionit, brenda kohës së përcaktuar në kontratë, ne presim bashkëpunim tuaj dhe të personelit që merret me shërbimin kontabël për të na berë të disponueshëm dokumentacionin kontabël,regjistrimet dhe informacione të tjera që do të kërkohen në lidhje me auditimin tonë.

Ju lutem konfirmoni marrjen e kërkesës dhe na krijoni mundësinë e një takimi në selinë e partisë tuaj sa më shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar termat e angazhimit të auditimit.

Përgjigjen drejtojeni në adresën në krye të shkresës.

Faleminderit!

E.S Financial Advisory shpk
Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR



Aspetti finanziari gjetor

X

2023

X

Partia e votuesve

X

Partia e votuesve

id

Emërtimi

Partia Politike

Viti

Vepimi

Niveli gjatë asnjë rekord.